

Siguria dhe shëndeti në punë është një shqetësim për të gjithë  
Është mire për ju. Është mire për biznesin



# Napo

Siguri me një buzëqeshje



Agjensia Europiane për  
Sigurinë dhe Shëndetin në Punë

**INAIL**

**inrs**

**suva**

**The Napo Consortium**



## KUSH ESHTË NAPO?

Napo është heroi i një serie filash të animuar, një bashkëproduksion i një grupi të vogël organizatash europiane, me qëllim që çeshtje të rëndësishme të sigurisë dhe të shëndetit në punë, të futen në një mënyrë të dashur, që të mbahen mend lehtësisht. Personazhi i këndshëm simbolizon një punonjës që mund të punojë në ndonjë degë apo sektor të industrisë.

Historitë e tij kanë vlera edukative; ato mund të provokojnë pyetje dhe të stimulojnë debate mbi aspekte të veçanta të sigurisë dhe të shëndetit në punë.

Filamt Napo janë lehtësisht të kuptueshëm, kështuqë njerëzit e të gjitha niveleve dhe kulturave mund t'a kuptojnë dhe të identifikohen me personazhin, që nga punonjësit e rinj e deri tek drejtuesit e nivelit më të lartë.

Në filma, shpesh herë Napo e sheh vetvehten si një viktimë e situatave të zakonshme, ndaj të cilave ai nuk ka kontroll, duke theksuar kështu rreziqet që mund të ekzistojnë në vendin e punës. Por ai mund t'i identifikojë rreziqet dhe risqet dhe të ofrojë zgjidhje praktike ose të bëjë sugjerime që e përmirësojnë sigurinë dhe organizimin e punës. Në këtë kuptim, ai është një punonjës ideal, pasi ai është i përfshirë aktivisht në procesin e vlerësimit të riskut.



**“Siguria me një buzëqeshje” është një kont**  
**të shëndetëshëm**

<http://www.napofilm.net>

## NAPO PER MESUESIT

Agjensia Europiane për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, së bashku me Konsorciumin Napo, është duke punuar mbi një projekt për t'i futur çeshtjet e shëndetit dhe të sigurisë tek fëmijët e shkollës fillore në një mënyrë edukative – të gëzueshme dhe që të zhvillon imagjinatën - duke përdorur klipet dhe aktivitetet krijuese të Napo. Konsorciumi ka përpunuar një seri instrumentash edukuese mbi çeshtjet e shëndetit dhe të sigurisë në punë nëpërmjet leksioneve që synojnë fëmijët e moshës 7 deri 11 vjeç.

Secila paketë studimi përshkruan mesazhet kryesore dhe objektivat e mësimi, duke u ofruar mësuesve hollësira të shumta mbi idetë e sugjeruara nga veprimtaritë dhe për burimet e kërkuara, së bashku me një model të një plani mësimor, i cili mund të përfshihet në një mësim tipik 45 minutësh.

Duke qenë se janë pilotuar me sukses, planet mësimore janë duke u zgjeruar dhe duke u zhvilluar për t'u përdorur në të gjithë Europën.

Për më shumë informacion mbi Napo për mësuesit, vizitoni faqen e tij në:

<http://www.napofilm.net/en/napo-for-teachers>



**tribut i Napo për vende pune më**

## ORIGJINA E NAPO

Napo është një ide origjinale, e konceptuar nga një grup profesionistësh të komunikimit për çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë, në përgjigje të nevojës për produkte informacioni të një cilësie të lartë, për të thyer kufinj të kombëtarë dhe për të adresuar kultura e gjuhë të ndryshme si dhe nevojat praktike të njerëzve në punë.



Konsorciumi i filmit - Agjencia Europiane për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë (EU-OSHA), së bashku me HSE (Mbretëria e Bashkuar), DGUV (Gjermani), INAIL (Itali), INRS (Francë), Suva (Zvicër) dhe AUVA (Austri) – u krijua nga Viti European i Shëndetit dhe i Sigurisë në Punë 1992 dhe nga festivali European i filmit, i mbajtur në Selanik në vitin 1992. Ata u takuan për të diskutuar mënyrat me të cilat mund të bëhej e mundur për komisionin që të prodhoheshin video për t'u përdorur në të gjithë Europën.

Video e parë, Histori me këngët më të mira, është paraqitur në festivalin e filmit të BE në Edinburg në vitin 1998, dhe fitoi çmime në kongresin botëror në Sao Paulo në vitin 1999 si dhe në festivalet kombëtare të filmit në Francë dhe Gjermani.

Që nga ajo kohë, Napo ka ndihmuar për të nxjerrë në pah rreziqet në vendin e punës për të gjithë Europën. Ai merr pjesë edhe në Fushatën mbarë europiane të EU-OSHA **Vende Pune të Shëndetshëm**, si një transmetues shumë i rëndësishëm i mesazheve të fushatës.

[www.healthy-workplaces.eu](http://www.healthy-workplaces.eu)

## NJE PERZGJEDHJE E FILMAVE

- Të punojmë së bashku
- Mushkëritë në punë
- Lëvizje të sigurta
- Mirëmbajtje e sigurtë
- Mbroni lëkurën tuaj
- E rrezikshme: kimikatet
- Siguri në ... Dhe jashtë punës
- Biznes i riskuar
- Ndriçoni ngarkesën
- Një start i sigurtë
- Ndaloni zhurmën
- Pastroni oxhakun
- Siguria në kantier
- Aventurat e NAPO
- Histori me këngët më të mira

**Konsorciumi Napo prodhon rregullisht filma të rinj.**

**Ju lutemi konsultohuni me faqen web:**

**<http://www.napofilm.net>**





**Na kontaktoni ne  
në facebook**



<http://www.napofilm.net>

Agjensia Europiane për Sigurinë  
dhe Shëndetin në Punë  
Gran Via 33, 48009, Bilbao, SPAIN  
Tel. +34 944794360  
Fax +34 944794383  
E-mail: [information@osha.europa.eu](mailto:information@osha.europa.eu)

<http://osha.europa.eu>

ISBN 978-92-9191-926-0



Agjensia Europiane për  
Sigurinë dhe Shëndetin në Punë